

VENDIM
Nr. 611, datë 22.9.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 656, DATË 31.10.2018,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË
SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shfuqizohen emërtesat e mëposhtme:

i. Këshilli i Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore;

ii. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi;

iii. Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm në Fushën e Shërbimit.

b) Shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Kulturës dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Tabelë

Emërtesa e Bordit/Këshillit/Komisionit	Numri maksimal i pagesave në një vit	Përbërja		Masa e shpërblimit në lekë	
		Kryetari	Numri i Anëtarëve	Kryetari	Anëtari
Bordi i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit	4	1	14	10.000	10.000
Komisioni për Skemat e Cilësisë	12	1	6	20.000	15.000
Komiteti për Skemat e Tjera të Cilësisë	6	1	10	15.000	10.000
Bordi Drejtues i Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë	12	1	10	15.000	15.000
Komisioni Disiplinor për Ndërmjetësit e Pasurive të Paluajtshme	12	1	4	15.000	10.000
Komisioni Qendror i Statusit "Fëmijë në përkujdesje të Republikës"	6	1	6	10.000	5.000
Komiteti i Etikës Mjekësore për Pajisjet Mjekësore	4	1	6	15.000	15.000
Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm për Profesionistët e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror	4	1	7	10.000	10.000
Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm për Profesionistët Shëndetësorë	4	1	9	10.000	10.000
Bordi i Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore	6	1	4	20.000	15.000
Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet	12	1	7	10.000	10.000
Bordi i Akreditimit të Muzeve	4		5		10.000